



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr.3143 Prot

Vlorë, më 10.10.2016

KONTRATË PËR KOLAUDIM PUNIMESH NDËRTIMI

(Pikë Panoramike dhe Sportive në Llogara)

Titulli i Kontratës: "Kolaudim Punimesh në objektin : "Pikë Panoramike dhe Sportive në Llogara".

Kjo Kontratë lidhet sot më datë 20 / 10 /2016 midis Këshillit të Qarkut Vlorë i përfaqësuar nga Z. Sadrit DANAJ tani e tutje i referuar si "Investitor" dhe bashkimit të operatorëve Margarita Kodra (Mehalla) dhe shoqërisë "Erald - G" që do të përfaqësohen nga ing. Margarita Kodra sipas prokurës së posaçme me nr. 4928/1 Rep dhe nr. 3194/1 Kol, datë 20.04.2015 me seli në Durrës, Manez, Banesë private një katëshe, 150 metra larg Kryqëzimit NIPT. L11606503B përfaqësuar nga drejtuesi ligjor Znj. Margarita Kodra, tani e tutje i quajtur si "Kontraktuesi", bazuar në dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 8402 datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Menjëherë pasi Kontraktori, me anë të ofertës së tij, më datë 18.10.2016 bie dakord të realizojë Punët, ashtu siç janë të specifikuara në këtë kontratë, si dhe pasi Investitori pranon Ofertën nga Kontraktori, në një shumë prej 42 000(dyzetë e dy mijë) lekë me TVSH për realizimin e Punëve;
Objekti i kësaj kontrate është kolaudimi i punimeve të zbatimit të veprës "Pikë Panoramike dhe Sportive në Llogara".

Palët bien dakort si më poshtë:

- 1.Kontraktuesi është i detyruar të kryejë Punët për Investitorin, siç kërkohet në këtë Kontratë.
- 2.Investitori është i detyruar të paguajë për Punët, në shumën e parashikuar në këtë Kontratë.
- 3.Palët e kësaj Kontrate kanë përgjegjësi për moszbatim ose zbatim të papërshtatshëm të detyrimeve të tyre kontraktore dhe për dëmet e shkaktuara secilës nga moszbatimi i detyrimeve, që janë subjekt kompensimi, në përputhje me Kushtet e Kontratës.
- 4.Kolaudatori i punimeve përgjigjet për :
 - a) realizimin e objektit në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standartet dhe rregullat teknike.
 - b) realizimin e objektit në përputhje me kontratën e nënshkruar.
 - c) përputhjen e dokumentave me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.
 - d) përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar,
 - e) dhe sqarimet përkatëse në rastet e mospërputhjes.

5. Kur vërehen difekte në verifikimet që përcaktohen në pikën 4, kolaudatori lë detyra me shkrim për punimet që duhet të kryhen, duke përcaktuar afatet e përfundimit të tyre në mënyrë që të plotësohen të gjitha kushtet e pikës 4.

Në varësi nga natyra e këtyre difekteve përcaktohen detyrimet e secilës palë.

6. Kolaudimi i veprës në fund të punimeve është i detyrueshëm.

7. Zhbllokimi i garancisë së kontratës do bëhet pasi të jetë përfunduar plotësisht kolaudimi i punimeve, ndërsa 5% i garancisë së punimeve për periudhën pas kolaudimit zhbllokohet pas përfundimit të garancisë së objektit.

8. Kolaudatori pas kolaudimit të objektit harton proces verbalin e kolaudimit, i cili firmoset nga kolaudatori, sipërmarrësi dhe mbikqyrësi i punimeve. Proces verbali duhet të përmbajë:

- a. Vendin e ndërtimit
- b. Emërtimin e objektit dhe funksionin e tij
- c. Datën dhe prejardhjen e projekteve si dhe ndryshimet e bëra në to.
- d. Vlerën e objektit
- e. Gjeneralitetet e sipërmarrësit
- f. Afatin e ndërtimit
- g. Vlerën e shpenzimeve (sipas regjistrave të kontabilitetit)
- h. Gjeneralitetet e kolaudatorit
- i. Kohëzgjatjen e kolaudimit
- j. Përshkrimin e verifikimeve të bëra mbi dokumentet dhe faktin si dhe rezultatet e arritura
- k. Proces verbali paraqitet në tre kopje dhe mbas regjistrimit kopjet i dergohen investitorit.

9. Periudha e garancisë për punimet e ndërtim-montimit në objektet, publike dhe jopublike, të përfunduara, fillon nga data e aktit të kolaudimit të punimeve dhe zgjat nga një deri në dy vjet, gjë që përcaktohet në kontratë, për veprën në tërësi a për pjesë apo procese të veçanta, në varësi të llojit të objektit, kompleksitetit dhe shkallës së vështirësisë së punimeve të kryera.

10. Investitori ose personi i autorizuar prej tij njofton zyrtarisht zbatuesin e punimeve për çdo defekt të ndodhur në vepër gjatë periudhës së garancisë. Zbatuesi është i detyruar ta ndreqë defektin brenda periudhës së garancisë dhe sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

11. Në përfundim të periudhës së garancisë, investitori, kolaudatori, mbikqyrësi dhe zbatuesi i punimeve bëjnë kontrollin përfundimtar të veprës. Për defektet që nuk janë ndrequr gjatë periudhës së garancisë së punimeve të ndërtim – montimit, investitori llogarit koston e ndreqjes së tyre dhe bën ndalesën nga vlera e garancisë së punimeve.

12. Kolaudatori i punimeve gjatë kolaudimit të veprës do të bashkëpunojë me mbikqyrësin e punimeve dhe ky i fundit do të përgjigjet kolaudatorit për të gjithë dokumentacionin e nevojshëm gjatë kolaudimit të veprës si dhe do të firmos proces verbalin e kolaudimit.

10. Për çdo mosmarrveshje palët duhet t'i zgjidhin me marrëveshje midis tyre në rast të kundërt mund të hejtohen për zgjidhje Gjykatës.

11. Kjo kontratë bëhet në pesë kopje, nga të cilat një e mban mbikqyrësi, dy kopje investitori, një kopje kolaudatori i punimeve dhe një kopje sipërmarrësi i punimeve.

Margarita KODRA

Administratori

Znj. Margarita Kodra



AUTORITETI KONTRAKTOR

Kryetari i Këshillit të Qarkut Vlorë

